



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

Nr. _____ Prot.

Datë, 28/05/2024

UDHËZIM PËR KZF-të

Bazuar në Rregulloren “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatit Akademik në Universitetin e Tiranës”, datë 10.02.2020, detyrimet të cilat duhet të zbatohen menjëherë KZF-të e Njësive kryesore të UT-së, për procesin zgjedhor, i cili është deklaruar i hapur në datën 21.05.2024, sipas Urdhrit të Rektorit të UT-së, nr. 02, datë 21.03.2024, me datë të zhvillimit të votimit për autoritetet drejtuese dhe Senatit Akademik të UT-së, datën 21.06.2024, Komisioni Insitucional i Zgjedhjeve të Universitetit të Tiranës,








UDHËZON:

1. Strukturat e Burimeve Njerëzore në të gjitha Njësitë kryesore të UT-së, Filialin e Sarandës dhe Institutin e Fizikës Bërthamore të Zbatuar, të hartojnë listat përfundimtare të zgjedhësve për personelin akademik, duke mbajtur parasysh ndjekjen e afateve dhe të procedurave të përcaktuara në nenin 11, pika 2, pika 3, pika 4, pika 5, pika 7, të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatit Akademik në Universitetin e Tiranës”, datë 10.02.2020.
2. Degët e Sekretarive Mësimore në të gjitha Njësitë kryesore të UT-së dhe në Filialin e Sarandës, të hartojnë listat përfundimtare të studentëve aktivë, duke mbajtur parasysh ndjekjen e afateve dhe të procedurave të përcaktuara në nenin 11, pika 6, të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatit Akademik në Universitetin e Tiranës”, datë 10.02.2020:



- Lista paraprake afishohet, dhe brenda një periudhë 10 ditore, sekretaria pranon kërkesat për korrigjimin e tyre.
 - Brenda 5 ditëve, sekretaria mësimore bën korrigjimet e kërkuara.
 - Pas 15 ditëve, shpallet lista përfundimtare e zgjedhësve studentë. Një kopje e tyre i dërgohet KIZ-it.
3. Komisionet e Zgjedhjeve të Fakulteteve (KZF-të) të Njësive kryesore të UT-të marrin masa për ngritjen e Komisioneve të Qëndrave të Votimit (KQV) duke mbajtur parasysh ndjekjen e afateve dhe të procedurave të përcaktuara në nenin 9 të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në Universitetin e Tiranës”, datë 10.02.2020 dhe Vendimet nga Nr. 56 deri në Nr. 61, datë 28.05.2024 të KIZ “Për miratimin e numrit të Qëndrave të Votimit pranë njësive kryesore të UT-së, Institutit të Fizikës Bërthamore të Zbatuar, dhe Filialit Sarandë”
4. KZF-të e Njësive kryesore të UT-së, IFBZ-së dhe Filialit të Sarandës publikojnë vendimet e KIZ dhe KZF në zbatim të nenit 7, pika 6, të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në Universitetin e Tiranës”, datë 10.02.2020.

KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

- | | | |
|---------------------|-----------|---|
| 1. Leticja Gusho | (Kryetar) |  |
| 2. Arjan Tushaj | (Anëtar) |  |
| 3. Alnida Koroshi | -//- |  |
| 4. Eljon Doçe | -//- |  |
| 5. Etlon Peppo | -//- |  |
| 6. Shaniko Allajbeu | -//- |  |
| 7. Dhurata Saraçi | -//- |  |

